



Funded by
the European Union



MNE-KOS
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

**TOURISM
FOR
FUTURE**

INFO-SESSION

THIRRJA APLIKIME PËR GRANTE

Çertifikim me Standardet Ndërkombëtare për Turizëm

ECO LABEL

Implemented by:
REA
Prishtina REA

In partnership with:



RRETH PROJEKTIT:

Prishtina REA, në bashkëpunim me Institutin IPER, Komuna e Kolashinit dhe Shoqatën Gjeravica nga Peja, po implementon projektin "**Tourism for Future**", i mbështetur nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi-Kosovë, nën Instrumentin për Ndihmë para Anëtarësimit (IPA II), si dhe me bashkë-financim nga komuna e Pejës, me synim, ndër të tjera:

- të ofrojë mbështetje për sektorin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore nga rajonet e Pejës dhe Kolashinit drejt vlerësimit, promovimit dhe instalimit të kulturës së re të punës së standardeve dhe certifikimit në zhvillimin ekologjik në Turizëm me Standardin Ndërkombëtar **Eco-Label**.

Qëllimi kryesor i projektit, pra, është të nxisë praktikat e **eco-turizmit të qëndrueshëm** në dy rajonet ndër-kufitare.

OBJEKTIVA PRIMARE:

- Rritja e demonstrimit të menaxhimit efektiv dhe të qëndrueshëm të sistemit të ekoturizmit në zonën ndërkufitare, duke marrë në konsideratë çështjet mjedisore, socio-ekonomike, të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë, si dhe çertifikimin me standardet ndërkombëtare Eco Label dhe ngritja e kapaciteteve,
- Rritja e përfitimeve sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal dhe zvogëlimi i ndikimeve negative, në terma kyçe si punësimi i komuniteteve lokale, mbështetja e iniciativave dhe mundësive për sipërmarrësit lokal për të përplotësuar sistemin e eco zhvillimit,
- Rritja e përfitimeve ndaj trashëgimisë kulturore, mjedisit, trashëgimisë natyrore, energjisë, mbetjeve, ujit, shtigjeve ekologjike, eco-produkteve si vlerë shtesë në raportin në mes ekoturizmit dhe natyrës si dhe unifikimin e kësaj lidhjeje të turit,
- Rritja e modernizimit të TIK-ut dhe ndërveprimi me tregun ndërkombëtar të sektorit të agro-ushqimeve.

THIRRJA PËR PER APLIKIME PËR GRANTE ÇERTIFIKIM ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TURIZËM ÉCO LABEL

- Projekti “Tourism for Future” është strukturuar për t’iu përgjigjur nevojave të sektorit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore në rajonin e Pejës dhe Kolashinit për të europeanizuar shërbimet si dhe klientelën e tyre.
- Komponenta 5.2.5 parasheh çertifikimin e entiteteve akomoduese turistike (hoteleve, resorteve, bujtinave, villave akomoduese) me standardet ndërkombëtare Eco Label në rajonet që mbulon projekti “Tourism for Future”.
- Çertifikimi me Standardin e Etiketës Ekologjike – si mjet i Menaxhimit të Turizmit të Qëndrueshëm është kryesisht i fokusuar në:
 - Infrastrukturë (energji, ujë, mbeturina),
 - Mjedisin,
 - Trashëgiminë Kulturore,
 - Agro-ushqimin/furnizimin lokal,
 - Kapacitetin e Menaxhimit të Qëndrueshëm në Turizëm, të njohura si vlerat e ekoturizmit.

BENEFITET NGA ÇERTIFIKIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TURIZËM ECO-LABEL

● Reputacioni dhe Vlera e Brendit:

Çertifikatat e standardit ndërkombëtar Eco-Label shënjojnë për klientët dhe industrinë, se një biznes është i përkushtuar ndaj praktikave të qëndrueshme. Kjo përmirëson reputacionin e biznesit dhe ngritë vlerën e brendit të tij, duke tërhequr turistë dhe partnerë të ndërgjegjshëm ndaj mjedisit.

● Diferencimi i Tregut:

Me një numër në rritje të udhëtarëve që e bëjnë prioritet qëndrueshmërinë, një standard i implementuar Eco-Label diferencon një entitet akomodues turistik nga konkurrentët e tij. Ajo shërben si një vulë e cilësisë dhe përkushtim ndaj kujdesit mjedisor, që mund të jetë një faktor vendimtar për turistët kur zgjedhin akomodime, ture dhe shërbime të tjera në kuadër të turizmit të qëndrueshëm dhe trashëgimisë.

● Qasja në Tregjet e Reja:

Agjencitë e udhëtimeve, destinimeve dhe operatorët turistik preferojnë të punojnë me biznese të çertifikuara ekologjikisht, duke hapur mundësi të reja biznesore. Gjithashtu, disa tregje, veçanërisht në Evropë dhe Amerikën e Veriut, janë më të prirura ndaj opsioneve të turizmit miqësor ndaj mjedisit.

● Efikasiteti Operativ:

Procesi i marrjes së një Çertifikate Eco-Label përfshinë adoptimin e praktikave më efikase dhe të qëndrueshme, siç janë reduktimi i konsumit të energjisë, minimizimi i mbetjeve dhe përdorimi i burimeve të ripërtitshme. Kjo çon në ulje të kostove e në të njëjtën kohë në rritje të cilësisë së shërbimit.

VLERA E GRANTIT DHE BASHKË-FINANCIMI

- Vlera e grantit i cili do të shfrytëzohet për implementimin dhe më pas çertifikimin me Standardet Ndërkombëtare për Turizëm Akomodues ECO LABEL do mbulohet nga projekti “Tourism for Future”, përmes kontraktimit të ofruesit certifikues të Akredituar ndërkombëtarisht për Eco Label,
- Vlera e bashkë-financimit do të variojë nga **1,000.00€** deri **2,500.00€**, varësisht nga madhësia biznesore a akomoduese e entitetit aplikues.

SHËNIM:

Kontributi i bashkëfinancimit në emër të subjekteve përfituese nga rajoni i Kolashinit do të mbulohet financiarisht nga Komuna e Kolashinit, sipas Shtojcës nr. 01, e hyrë në fuqi më 29 dhjetor 2023.

PERIUDHA PËR ZBATIMIN E GRANTEVE

- PERIUDHA IMPLEMENTUESE: **4 – 9 MUAJ**
- PROLONGIME SHITESË NUK LEJOHEN!

Vërejtje: intervenimet e nevojshme për çertifikim pas vizitës inspektuese të njësisë audituese, duhet të ndërmerren nga vet aplikanti, në mënyrë që të arrihen kriteret e kërkuara për çertifikim

PROCEDURA E KOMPLETIMIT TË GRANTEVE

VETËM PAS ÇERTIFIKIMIT ME STANDARDIN ECO – LABEL

KUSH MUND TË APLIKOJ?

KRITERET E PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIT:

PËR TË QENË TË KUALIFIKUAR, APLIKANTËT DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E MËPOSHTME:

Aplikanti është një entitet aktiv biznesor ose entitet ligjor, i inkorporuar sipas Ligjeve në fuqi /vendimeve ligjore për Organizatat e Biznesit në ministri përkatëse dhe i themeluar në:

Kosovë: Pejë, Istog, Deçan ose **Mal i Zi:** Kolashin, Berane, Rozaje

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) që operojnë në sektorin e turizmit në posedim të të paktën 2 dhomave, idealisht që demonstrojnë ose synojnë për inovacion në turizëm, të operojnë brenda kategorive të mëposhtme, në përputhje me këto kodet/aktivitetet biznesore bazuar në Eurostatit2:

- 55 Akomodim
- 55.10 Hotele, resorte turistike dhe akomodime të ngjashme
- 55.20 Pushimore dhe njësi akomoduese të tjera për qëndrime të shkurtra
- 55.30 Kampet, parqet rekreative akomoduese me kamp-shtëpiza
- 55.90 Njësi Akomoduese të tjera (bujtina, guest-house, villa, shtëpi malore turistike etj)

KRITERET E PËRZGJEDHJES

- Aplikanti duhet të ketë **burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financiare** për të operuar me aktivitetin e tij biznesor gjatë periudhës së zbatimit operues të projektit dhe të marrë pjesë në bashkë-financimin e tij sipas kontratës së grantit.
- Aplikanti duhet të ketë **aftësi dhe kualifikime profesionale** (teknike dhe menaxheriale) të nevojshme për përfundimin e aktiviteteve të propozuara dhe kapacitetin për të menaxhuar një operim biznesor akomodues-turistik të nivelit dhe madhësisë së operimit biznesor

KRITERET E PËRZGJEDHJES

● Kapaciteti financiar i aplikantëve

Aplikantët duhet të dëshmojnë se kanë kapacitete financiare dhe operacionale për të përfunduar implementimin e grantit që do të mbështetet duke dëshmuar të paktën 20.000 Euro si qarkullim vjetor të vitit të kaluar (siç është Deklarata e qarkullimit bankar, Deklarata Vjetore raportuese e Administratës Tatimore, raporti i Auditim Financiar). Ata duhet të paraqesin pasqyrat e tyre financiare vjetore si, bilanci I gjendjes, llogaria e fitimit dhe humbjes dhe çdo shtojcë mbështetëse për vitin e fundit financiar për të cilin janë mbyllur llogaritë.

● Aftësi dhe kualifikime menaxhuese profesionale

Aplikantët duhet të dëshmojnë kapacitetin profesional, teknik, operacional dhe menaxherial për të përfunduar projektin e propozuar dhe duhet të paraqesin dokumente mbështetëse, duke dëshmuar se kanë të paktën dy staf të me kohë të plotë (full-time), (përmes dëshmimeve si raporti ose Lista e Stafit e raportuar në Administratës Tatimore në 6 muajt e fundit, si dhe me CV të detajuar të stafit përgjegjës për zbatimin e projektit, përshkrimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndërlidhura me projektin e dorëzuar, gjatë tri viteve të fundit të përvojës së tyre, etj.).

Shënim: Kriteret e përzgjedhjes do të vlerësohen gjatë fazës së parë (Admin check) nga komisioni i vlerësimit. Dështimi për t'u përmbushur këto kriteria do të rezultojë në mosvlerësimin e mëtejshëm të propozimit nga komisioni vlerësues. Aplikantëve mund t'u kërkohet të paraqesin dëshmi shtesë ose të sqarojnë dokumentet mbështetëse të ndërlidhura me kriteret e përzgjedhjes.

KRITERET KRYESORE TË VLERËSIMIT

Kriteret vlerësuese për çdo kërkesë do të ndjekin rregullat si në vijim:

Rregulla 1: Aplikimet do të renditen bazuar në pikët e tyre të përgjithshme (shuma e kriterit 1 deri në 3);

Rregulla 2: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 1, ka Aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet aplikimeve që kanë pikë më të larta në kriterin e vlerësimit 1: "objektivat e projektit 'Tourism for Future' dhe ndikimet e pritshme";

Rregulla 3: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 2, ka aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet aplikimeve që kanë pikë më të larta në kriterin e vlerësimit 2: 'Ndikimi';

Rregulla 4: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 3, ka aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet atij që është dorëzuar më herët sipas datës së aplikimit.

KRITERET PËRZGJEDHËSE PËR GRANT

KRITERI PËRZGJEDHËS 1: Respektimi i objektivave të projektit “Tourism for Future” dhe konceptit Eco Label

Aplikantët duhet të demonstrojnë një set të qartë objektivash, të cilat janë në linjë me definimin e Objektivave të Tourism for Future veçmas të objektivave të visioni të Eco Label dhe green key eco-tourism

10 PIKË

KRITERI PËRZGJEDHËS 2: Gatishmëri dhe Impakti (ndikimi)

Aplikantët duhet të demonstrojnë që rezultat e pritshme dhe impakti i Tourism for Future po mbështetet dhe janë inkorporuar fuqishëm në aplikimin për grant, duke u fokusuar në:

- a) Natyrën/ambientin përreth
- b) Infrastruktura e instaluar operacionale (eficienca dhe kursimi i energjisë dhe ujit, zvoglimi i mbetjeve
- c) Furnizimet lokale nga komuniteti përreth,
- d) Integrimi me trashëgimin kulturore të zones
- e) Kapacitetet profesionale meaxhuese për turizëm të qëndrueshëm

20 PIKË

KRITERI PËRZGJEDHËS 3: Arsyeshmësiar e transicionit drejt Qëndrueshmërisë sipas konceptit Eco Label

Aplikantët duhet të demonstrojnë evidence kredibile që ekipi i projektit është i zotuar për t’u avancuar/ngritur dhe posedon shkathtësitë e nevojshme, përvojën menaxheriale dhe kapacitetet financiare për të qenë i gatshëm të implementoj grantin e dhëna nga Tourism for Future sipas objektivave të tij

20 PIKË

KRITERI PËRZGJEDHËS 4: i) Kapacitetet financiare, ii) mundësitë për investime, iii) zotimin e bashkëfinancimit si dhe iv) metodologjinë e menaxhimit të riskut

Aplikantët duhet të demonstrojnë përmes dëshmive zyrtare të katër nënkriteret sikur më lartë

10 PIKË

POENTIMI I PËRGJITHSHËM:

60 PIKË

FORMULARI PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE PËR GRANT

- Aplikimet duhet të dorëzohen duke përdorur sistemin e aplikimit sipas udhëzuesit dhe formatit të aplikimit.
- Udhëzimet dhe video-instruksionet se si të plotësohen format e aplikimit dhe lidhja për në sistemin e dorëzimit duke respektuar format e aplikimit janë të dispozicion në platformën elektronike të Tourism for Future: <https://grante.tourismforfuture.com>
- Aplikimet që nuk i përmbushin këto kërkesa formale nuk do të vlerësohen më tej.
- Data e mbylljes për Aplikim është 26.01.2024 para orës 23:59h (CET).
- Aplikimet e dorëzuara pas datës së mbylljes nuk do të merren në konsideratë.
- Aplikantëve u këshillohet të mos presin deri në minutën e fundit për të ngarkuar format e tyre të aplikimit në mënyrë që të shmangen rreziqet e një dorëzimi të dështuar për shkak të një sistemi të ngarkuar në orët fundit të aplikimit.



Funded by
the European Union



MNE-KOS
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

**TOURISM
FOR
FUTURE**

grante.tourismforfuture.com

Çertifikim me Standardet Ndërkombëtare
për Turizëm **ECO LABEL**

Implemented by:

REA
Prishtina REA

In partnership with:

